



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**  
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE**

---

**VENDIM**

Nr. 14, Dt. 20.01.2009

***Per shpalljen e zones te burimeve te Ujit te Ftohte Vlore, "zone e Mbrojtjes Emergjence"***

Duke u bazuar ne kerkesat e Ligjit Nr.8093, dt. 21.03.1996, "Per rezervat ujore", nenet 40 dhe 41, si dhe ne kerkesat e parashtruara nga investitori dhe donatori, per rehabilitimin e ujesjellesit te Vlores, per mbrojtjen e burimeve te Ujit te Ftohte qe furnizojne qytetin e Vlores me uje te pijshem, si dhe nga gjendja aktuale e ndertimeve me dhe pa leje dhe nga rrezikshmeria qe ato paraqesin, te permblodhur dhe ne relacionin e paraqitur nga A.U.B "Vjose", K. B U. "Vjose"

**VENDOSI:**

- 1- Te shpallet zone e *Mbrojtjes Emergjente*, siperfaqja tokesore, e burimeve ujore, te Ujit te Ftohte Vlore, (zonat e mbrojtjes te afert me rreze 120 m, per cdo burim ujqor).
- 2- I propozohet dhe kerkohet K.K.U-se, qe zona e burimeve te Ujit te Ftohte Vlore, te shpallet zone me mbrojtje te vecante.
- 3- Ky vendim tu behet i njohur, gjithe institucioneve qe japin leje ndertimi ose legalizojne ndertime pa leje (Keshillit te Qarkut Vlore, Bashkise Vlore dhe ALUIZNI Vlore).
- 4- Per zbatimin e ketij vendimi, ngarkohet A.U.B "Vjose".
- 5- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

**PERGJEGJESI I A.U.B-se "VJOSE"**

**Vezir METAJ**



**KRYETAR I K.B.U-se "VJOSE"**

**Hasan HALILI**

